



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 12.4.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Salih Morina, Sevdije Lama, Etem Arifi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 30.3.2011.
3. Vizita e komisionit në Kuvendin e Shqipërisë.
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për takimin dyditor në fsh. Brod (Dragash).
5. Shqyrtimi i raportit vjetor nga ZRRUM dhe propozimit për një anëtar në komisionin shqyrtues në këtë zyre.
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 30.3.2011

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa ndonjë vërejtje, me sugjerimin e z. Nijazi Idrizi që procesverbali duhet të përmbajë gjërat e sakta nga një mbledhje e mbajtur, për çka është dakorduar me stafin.

3. Vizita e komisionit në Kuvendin e Shqipërisë

Kryesuesi Nait Hasani njoftoi komisionin se ambasada e Shqipërisë në Prishtinë ka njoftuar këtë komision për ftesën e komisionit homolog sipas iniciativës së shprehur nga ky komision dhe mirëpresin këtë vizitë duke hequr shpenzimet për 5 anëtarë të delegacionit, ndaj është proceduar menjëherë kërkesa në kryesi, e cila sot do të vendos për vizitën e 7 anëtarëve të delegacionit, 5 deputet dhe 2 nga administrata (vozitësi me zyrtarin e komisionit), për dy anëtarë shtesë është kërkuar ti heq shpenzimet ky Kuvend. **Nijazi Idrizi** u interesua për përmbajtjen e kësaj vizite, ndërsa kryesuesi sqaroi se vizita do të shërbej për bashkëpunim të ndërsjellë me komisionin homolog në Shqipëri si dhe për njohuri me përvojat e tyre, që do të janë t' mirëseardhura për këtë komision.

Komisioni u pajtua që delegacioni për vizitën e dt. 18 dhe 19 prill 2011 në parlamentin e Shqipërisë do të përbëhet nga : **Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Salih Morina dhe Sevdije Lama**. Nga stafi **Ylber Sherifi** dhe **vozitësi**. Në vizita tjera përparësi do të kanë anëtarët që nuk shkojnë në vizitë kësaj here (ky parim do të vlen edhe për stafin).

4. Shqyrtimi planit të punës së Komisionit për takimin dyditor në fsh. Brod (Dragash)

Kryesuesi Nait Hasani lidhur me këtë pikë tha se ka qenë deshtë të mbahet më herët takimi dyditor i komisionit i paraparë me mbështetje të OSCE, por shkaqet objektive ishin ato që sollën ndryshimin. Pasi që **Sevdije Lama** kërkoi sqarime, **kryesuesi** dhe **Blerim Vela** (OSCE) sqaruan se takimi do të shërbej komisionit për detalizimin e planit të punës së komisionit sipas agjendës së propozuar nga OSCE dhe plotësimit eventual nga komisioni p.sh. do të zërthehet puna konkrete e shqyrtimit të një projektligji që ka arritur në Kuvend në fushën e këtij komisioni. **Blerim Vela** poashtu kërkoi emrat saktë kush do të marr pjesë në këtë takim më 26 dhe 27 prill në fsh. Brod, për të pasur mundësinë për ftesa shtesë të zyrtarëve tjerë, por jo ekspertë ashtu si propozoi **Salih Morina**, por këta do të jenë kontribuues profesional për mbarëvajtjen e punës së komisionit. Në parim komisioni u deklarua se do të **prezantoi komplet** në këtë takim dyditor, ndërsa kryesuesi obligoi z. Vela të kontaktoi me Naser Rugovën dhe Berat Luzhën se a dëshirojnë me ardhë për të dhënë sqarime të duhura për punën që planifikohet sipas agjendës, si ish anëtarë të këtij komisioni. Kryesuesi obligoi stafin që në kontakt me zyrtarët e OSCE të ndërmarrin veprimet e duhura në favor të përgatitjes sa më të mirë të takimit të paraparë në Dragash. Transporti do ti takoj Kuvendit, ndërsa për deputetin **Rasim Demiri** nuk do të ketë nevojë përkthyes.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor nga ZRRUM dhe propozimit për një anëtar në komisionin shqyrtues në këtë zyre

Para se të marr fjalën **Raif Preteni** (drejtor në ZRRUM) lidhur me raportin vjetor, kryesuesi **Nait Hasani** sqaroi çështjen e emërimit (propozimit nga ky komision) të një anëtari në komisionin shqyrtues në ZRRUM. Ai konstatoi se ky komision që tentohet të formohet e ka bazën ligjore në nenin 34 të Ligjit në fuqi lidhur me këtë zyre, mirëpo askund nuk saktësohet pagesa e këtij anëtari, ndaj për shkak të kësaj zbrazëtie juridike edhe Kuvendi (Komisioni) nuk mund të propozoj këtë anëtarë për nominim. Mbetet që të bëhen sqarimet shtesë, pastaj të vazhdoj procedimi adekuat. Komisioni nuk kishte vërejtje në këto konstatime të kryesuesit. **Raif Preteni** gjithashtu arsyetoi mos mundësinë e financimit të këtij anëtari nga ZRRUM, ngase që nga muaji i ardhshëm kjo zyre ka mungesë mjetesish edhe për stafin e ZRRUM-it për paga. Kryesuesi sugjeroi që kjo të rregullohet me anë të plotësimit- rishikimit të buxhetit për 6 mujorin e ardhshëm, sipas iniciativës nga kompetentët e zyrës.

Raif Preteni-drejtor raportoi shkurtimisht për vitin 2010 për këtë zyre (raportimi i tretë me radhë nga kjo zyre) duke pas parasysh që deputetët janë njoftuar edhe me shkrim nga kjo zyre. Ai shtoi se gjatë periudhës prej që është emëruar në këtë zyre (prill 2010) ka pasur

trendë pozitive të performancës së kompanive ujore dhe të mbeturinave kur edhe janë duke u zhvilluar auditimet përkatëse për vitin 2010. Pakënaqësitë janë ato të vjetrat, sidomos sa i përket shkallës së arkëtimit për çka kompanitë kanë vështirësi për mbulimin e shpenzimeve cilësore. Kjo zyre ka pasur takim me asociacionin e Komunave, në lidhje me marrëveshjen e shërbimit në mes të KRU dhe Komunave. Ligji i Mbeturinave që është duke u amendamentuar, rregullon marrjen e kompetencave nga ZRRUM, do të diskutohet në këtë komision parlamentar me siguri pas leximit në parim. Sanksionet kanë filluar të shqiptohen (p.sh. është një dënim për KMDK), por për shkak të ankesave që tani parashtrihen, nevoja është për themelimin e komisionit shqyrtues të lartcekur. Kjo zyre ka mjaft probleme financiare, ndaj drejtori kërkoj përkrahje duke propozuar bashkëpunim shumë të ngushtë në çdo aspekt, nëse ka nevojë edhe gjatë hartimit të rekomandimit për Kuvendin.

Nait Hasani falënderoj për këtë raport, ndaj pyeti anëtarët e komisionit për sugjerime eventuale se a do të kaloi ky raport apo do ti kthehet parashtruesit për plotësim.

Daut Haradinaj pyeti pse hezitojnë disa komuna të nënshkruajnë lidhur me kompetencat e parashtruara nga drejtori, i cili pastaj sqaroi se disa komuna mendojnë se kompetencat duhet ti takojnë atyre në tërësi, derisa ligji definon ndryshe ngase kompetencat janë në anën e Qeverisë si pronare të aseteve. **Sevdije Lama** pyeti cilat janë ato komuna (duke aluduar në Gjakovë). Raportuesi u përgjigj dhe tha p.sh. Gjakova thotë jo ndërsa Peja thotë po (nënshkrimi), ngase Gjakova mendon se duhet amenduar ligjin në fuqi (Qeveria të mirët vesh me Komunat). **Liburn Aliu** pyeti pse është kështu dhe si ka qenë përpara, në çka raportuesi u përgjigj se përpara kanë qenë kryesoret komunat, ndërsa regionalizimi është shumë i arsyeshëm (tani janë 7 regjione), ngase disa komuna nuk kanë nevojë të mëvetësohen (lidhur me mbledhjen e mbeturinave). Të gjitha këto kompetenca tani tenton ti marr komuna. **Daut Haradinaj** pyeti konkretisht pse Deçani nuk bashkëpunon me Pejën sa i përket ujit dmth nuk i jap ujë. Raif Preteni tha se kjo është jologjore ngase këto kompetenca i takojnë ministrisë (MMPH). **Afërdita Berisha** pyeti për Suharekën pse nuk ka përmirësime sa i përket furnizimit me ujë, në çka drejtori i ZRRUM reagoi në mosfunksionimin e menaxhimit, pra duhet të jap përgjigje Bordi sipas raportit nga ZRRUM. **Salih Morina** pyeti pse aksionari nuk auditohet edhe nga jashtë sepse do të ishte edhe në dobi të gjithanshme, të cilin pyetje edhe raportuesi arsyetoi dhe siguroi që kjo tanimë ka filluar me auditorim gjeneral, për të cilat gjetura kjo zyre do të informoi rregullisht komisionin. **Daut Haradinaj** vazhdoi me pyetjen rreth ujërave në rajonet e bjeshkëve, kush do të jetë përgjegjës dhe pronarë i atyre ujërave, ngase sa i përket ujërave siç shihet nuk ka licenca adekuate. Përgjigja ishte se MMPH duhet të ketë këtë kompetencë. **Nijazi Idrizi** pasi që konstatoi fillimisht se ka pas përpara trendë pozitive në këtë lëmi ndërsa tani jo, pyeti mos është fajtorë për këtë pakoja e Ahtisarit apo duhet të bëhet bartja e përgjegjësisë, sepse siç dihet edhe tek pakoja e Ahtisarit janë disa probleme. Drejtori u përgjigj se fajtori kryesor qëndron në mosharmonizimin e 4 ligjeve kryesore sa i përket ujërave, megjithatë ai konstatoi se nga fillimi i vitit 2010 ka filluar të përmirësohet performanca e cekur nga deputeti Idrizi, në krahasim me vitet e mëparshme. **Liburn Aliu** kërkoi sqarimin rreth “borxheve të vjetra” në kapitullin e dytë të raportit me shkrim, çka është tentuar të thuhet. Drejtori u përgjigj se fjala është për borxhe të cilat assesi nuk duhet të lejohen të vjetrohen dhe të shlyhen me falje (siç është vepruar përpara me UNMIK-un), ai shtoi se gjatë vitit 2010 asnjë borxh nuk është falë, njëherit apeloj që në këtë front të prijnë institucionet shtetërore (të paguajnë borxhet). **Afërdita Berisha** pyeti “si po mendoni të paguaj dikush, nëse p.sh. nuk ka pas ujë”. Raportuesi shprehu pajtimin, por shprehu brengosjen për këtë sepse qytetarët hezitojnë të nënshkruajnë kontratën me kompanitë përkatëse, për çka kjo zyre ka kërkuar të shtohet stafi sa i përket inspektimeve të vendimeve të ZRRUM në terren.

Kryesuesi falënderoi mysafirët dhe pasi që u larguan, pyeti komisionin për miratimin e raportit në fjalë. **Nijazi Idrizi** nuk kundërshtoi miratimin por sugjeroi që rekomandimi të përfshijë shembujt e mirë që u cekën në këtë takim (në arsyetim), me ç’rast komisioni duke aplikuar sugjerimet-vërejtjet nga kjo mbledhje, me vota unanime nxori :

R e k o m a n d i m

Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi në mbledhjen plenare Raportin vjetor për vitin 2010 nga Rregullatori për Ujëra e Mbeturina.

6. Të ndryshme

Kryesuesi propozoi që komisioni të filloj realizimin e planit sa i përket vizitës së komunave, fillimisht në Rahovec më 15 prill në orën 9,00. Për këtë vizitë komisioni u pajtua. **Nijazi Idrizi** tha se nuk do të ketë mundësi të prezantoj. **Liburn Aliu** dhe **Afërdita Berisha** u interesuan që të takohen në këtë komunë edhe me ndonjë shoqatë të bujqve dhe të vreshtarëve për të bashkëbiseduar rreth iniciativës së donatorëve (USAID) për projekte siç është p.sh. fermerët që kontribuojnë për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Kryesuesi u angazhua të bisedoi me kryetarin e komunës së Rahovecit dhe stafi të hartoi agjendën zyrtare për këtë vizitë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,15.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani